



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“SHËRBIME MJETESH TË RËNDA TRANSPORTI”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

M5-III-16

Tirane më, Gusht 2016

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Shërbime mjetesh të rënda transporti”			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	M5-III-16
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional në profilin “ Shërbime mjetesh të rënda transporti ” niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të rënda të transportit, si dhe të <i>zhvillojë personalitetin e nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon</i>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Shërbime në mjetet e rënda të transportit” të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme në kualifikimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK,; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime mjetesh të rënda transporti”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushw. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të shërbimeve për mjete të rënda transporti, në pika servisi të mjeteve të transportit, si dhe në veprimtari të tjera që operojnë në këtë drejtim;</p> <p>Gjithashtu, ai/ajo mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve të rënda të transportit;</p> <p>Me përfundimin e arsimimit të profilit “Shërbime të mjeteve të rënda të transportit”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin e IV të kualifikimit profesional (njëvjeçar) të drejtimit “Shërbime mjetesh transport” dhe fiton të drejtën e Diplomës së “Maturën Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare;</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e	Nuk ka			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “**Shërbime mjetesh të rënda transporti**” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Planifikim, organizim dhe përgatitje e vendit të punës për punimet në “mjetet e rënda të transportit”:

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të përshkruajë karakteristikat e konsumatorëve;
- Të shpjegojë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre;
- Të shpjegojë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të shpjegojë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të tregojë se ç’janë shërbimet në mjetet e rënda të transportit dhe të argumentojnë rëndësinë e tyre;
- Të bëjë klasifikimin (grupimin) e mjeteve të rënda të transportit sipas qëllimit për të cilin ato janë projektuar;
- Të bëjë klasifikimin e shërbimeve në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e një servisi për shërbimet në mjetet e rënda të transportit;
- Të dallojë dhe tregojë përdorimet e veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës në një servis për shërbimet në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë si bëhet organizimi dhe ndarja e punës në një servis për shërbimet në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë veprimet për sigurimin e bazës materialo-teknike për shërbimet në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë veprimet për kontrollin paraprak në mjetet e rënda të transportit, si dhe për pranimin e tyre;
- Të përshkruajë veprimet për vendosjen e mjeteve të rënda të transportit në vendin e kontrollit për shërbimet e nevojshme;
- Të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e mjeteve të rënda të transportit;
- Të tregojë si përdoret informacioni nga burime të ndryshme për shërbimet në mjetet e rënda të transportit;
- Të tregojë si interpretohet dhe si plotësohet dokumentacioni teknik për shërbimet në

mjetet e rënda të transportit;

Proceset e punës për shërbimet motorike në mjetet e rënda të transportit:

- Të përshkruajë procedurat e çmontimit dhe të montimit të motorit në automjet;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të trupit të motorit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të kokës së motorit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të cilindrave të motorit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të mekanizmit bjellë-manivelë të motorit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve të motorit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të vajtjes së motorit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të ftohjes së motorit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të elementeve të sistemit të ushqimit të motorit “diesel”;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të pompave të naftës;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, shërbimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të ushqimit të motorit me injeksion naftë ;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të shkarkimit të produkteve të djegies;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, shërbimit dhe mirëmbajtjes të baterisë;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit alternator-rregullator;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të lëshimit të motorit;

Proceset e punës për shërbimet xhenerike në mjetet e rënda të transportit:

- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të friksioneve mekanike;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të friksioneve hidraulike;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të mekanizmave të komandimit të friksioneve;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të kutive manuale të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, shërbimit dhe mirëmbajtjes të kutive automatike të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të mekanizmave të komandimit të kutive të ndërrimit të shpejtësisë;

- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të transmisioneve kardanike;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të transmisioneve kryesore;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të diferencialeve;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të gjysmëboshteve;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit akseve të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të varëseve të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrotave të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e balancimit dhe regjistrimit të këndeve të rrotave;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të drejtimit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të përforcuesve të sistemit të drejtimit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të frenimit hidraulik;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të frenimit pneumatik dhe hidropneumatik;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të frenave të dorës;

Proceset e punës për shërbimet e karrocërisë në mjetet e rënda të transportit:

- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit të parregullsive në karrocërinë e mjeteve të rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e çmontimit dhe të montimit të elementeve të karrocërisë së mjeteve të rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes dhe riparimit të karrocërisë së mjeteve të rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e drejtimit të karrocërisë dhe të pjesëve të karrocërisë, të shformuara;
- Të përshkruajë procedurat e saldimit dhe ngjitjes së elementeve metalike të dëmtuara të karrocërisë;
- Të përshkruajë procedurat e ngjitjes së elementeve jo-metalike të dëmtuara të karrocërisë;
- Të përshkruajë procedurat e stukimit dhe lyerjes së pjesëve të dëmtuara të karrocërisë;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të xhamave në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të dyerve në mjetet e rënda të transportit;

- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të kolonave të dyerve në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të mbulesës së motorit në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit ose zëvendësimit të bravave dhe dorezave dyerve në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit ose zëvendësimit të mekanizmave të komandimit të xhamave në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit ose zëvendësimit të pasqyrave dhe fshirëseve të xhamave në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit ose zëvendësimit të kroskotit në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e riparimit dhe të zëvendësimit të tapicerisë në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të parafangove, parakolpeve dhe pjesëve të tjera plastike ose metalike në mjetet e rënda të transportit;

Proceset e punës për shërbimet në pjesën agregate(në pjesën punuese për të cilën janë projektuar) mjetet e rënda të transportit:

- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit të sistemit hidraulik të komandimit të organeve punuese të agregateve në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e diagnostikimit të elementëve përbërës të agregateve të mjeteve të rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes dhe riparimit të pompës hidraulike të agregatit të mjeteve të rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e shërbimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të zinxhirëve në mjetet e rënda të transportit;
- Të shpjegojë procedurat e shërbimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të hidromotorit në mjetet e rënda të transportit;
- Të shpjegojë procedurat e shërbimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të shpërndarësve hidraulik në mjetet e rënda të transportit;
- Të shpjegojë procedurat e shërbimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të cilindrave hidraulik punues në mjetet e rënda të transportit;
- Të shpjegojë procedurat e shërbimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të strukturës metalike (kolonës kryesore, krahëve punues, kovës, thikës etj.;) në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë procedurat e saldimit të elementeve metalike të dëmtuara të (kovës , thikës etj.;) në mjetet e rënda të transportit;

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “**Shërbime mjetesh të rënda transporti**” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë shprehinë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Planifikim, organizim dhe përgatitje të punimeve në motor

- Të organizojë vendin e punës për punimet motorike të mjeteve të transportit;
- Të përzgjedhë, përdorë dhe mirëmbajë makinat, pajisjet, veglat dhe materialet e punës për punimet motorike;
- Të zbatojë standardet e profesionit të motoristit;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik për punimet motorike;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar të nevojshëm për pranimin dhe kryerjen e shërbimeve motorike në mjetet e transportit;
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura sipas proceseve të punës për shërbime motorike në mjetet e transportit;
- Të përdorë metoda të ndryshme komunikimi;
- Të punojë në grup;
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve të kryera:

Punime në motor

- Të çmontojë motorin nga automjeti;
- Të çmontojë nyjet kryesore të motorit;
- Të zbërthejnë pjesët e nyjeve të motorit;
- Të pastrojë pjesët e nyjeve të motorit;
- Të seleksionojë pjesët e motorit;
- Të kryejë matje dhe kontrole të nevojshme për shërbime motorike (matje me mikrometër, me komparator, me pajisje të tjera të avancuara, matje të shkallës së kompresionit, matje të presionit, matje të temperaturës së vajit në sistemin e vajisjes etj.), me pajisjet përkatëse;
- Të kryejë punime axhusterie në pjesët motorike;
- Të kryejë punime të saldimit dhe ngjitjeje në motor;
- Të kryejë punime grasatuese në pjesët motorike;
- Të montojë pjesët e nyjeve të motorit;
- Të montojë nyjet në motor;
- Të montojë në motorin në automjet;
- Të kryejë punime të riparimeve të çastit në motor;
- Të kryejë regjistrimet e duhura në motor;
- Të bëjë kontrollin përfundimtar të funksionimit të motorit;
- Të përpilojë listën e materialeve të nevojshme për punimet motorike;
- Të përcaktojë kohën e nevojshme të punës për punimet motorike;
- Të përcaktojë vlerën paraprake të punimeve motorike që do të kryhen;

Punime motorike të veçanta

Në mekanizmin bjellë-manivelë dhe mekanizmin e shpërndarjes së gazeve:

- Të bëjë provën e funksionimit të motorit;
- Të bëjë kontrollin e kompresionit të cilindrave;
- Të bëjë diagnostikimin e cilindrave ose të këmishave të cilindrave;

- Të bëjë matjen e cilindrave ose të këmishave të cilindrave;
- Të bëjë kontrollin në hermetizim të cilindrave ose të këmishave të cilindrave;
- Të bëjë kontrollin e konsumit të udhëzuesve të valvulave;
- Të kryejë punime honingimi në cilindrato e motorit;
- Të bëjë kontrollin në hermetizim të kokës së motorit;
- Të bëjë diagnostikim të bronzinave të bjellave dhe të boshtit motorik;
- Të bëjë heqjen dhe vënien e këmishave të cilindrave;
- Të bëjë zëvendësim të pistonave;
- Të bëjë zëvendësim të fashove të pistonave;
- Të bëjë zëvendësim të spinotave të pistonave;
- Të bëjë zëvendësim të bronzinave të biellave;
- Të bëjë zëvendësim të boshtit motorik;
- Të bëjë zëvendësim të bronzinave të boshtit motorik;
- Të bëjë zëvendësim të volantit të boshtit motorik;
- Të bëjë zëvendësim të demferit (shuarësit të lëkundjeve);
- Të bëjë zëvendësimin e permistopit të boshtit motorik;
- Të bëjë zëvendësimin e nënkarterit të motorit;
- Të bëjë zëvendësimin e kokës së motorit;
- Të bëjë zëvendësim të guarnicionit të kokës së motorit;
- Të kryejë regjistrime në mekanizmin e shpërndarjes së gazeve;
- Të kryejë çmontime, pastrime dhe montime të pjesëve të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve;
- Të bëjë zëvendësimin e boshtit me gunga dhe bokolave mbështetëse;
- Të bëjë zëvendësimin e zinxhirit ose rripit të motorit;
- Të bëjë zëvendësimin e tensionuesit të zinxhirit ose rripit të motorit;
- Të bëjë zëvendësimin e valvolave, sustave, sedieve, bokolave udhëzuese, shtytësave dhe shtagave të valvolave;
- Të bëjë zëvendësimin e guarnicionit të bishtit të valvulave;
- Të bëjë zëvendësimin e bilancierëve, regjistruuesve, boshteve dhe bokolave të tyre;
- Të bëjë kontrollin për konsumim të udhëzuesve të valvulave;
- Të bëjë çmontim dhe montimin të kapakut të distribucionit;
- Të kontrollojë dhe të bëjë vënien në fazë të motorit;

Në sistemin e vajosjes:

- Të kryejë punime të zakonshme në sistemin e vajosjes së motorit;
- Të bëjë zëvendësimin e vajit të motorit;
- Të bëjë pastrimin e nënkarterit dhe kanaleve e tubave të vajit;
- Të bëjë zëvendësimin e pompës së vajit të motorit;
- Të bëjë zëvendësimin e këmbyesit të nxehtësisë vaj-ujë të motorit;
- Të bëjë zëvendësimin e tubit të vajit hyrës dhe dalës të turbinës së motorit;
- Të bëjë zëvendësimin e filtrit paraprak të vajit të motorit;
- Të bëjë zëvendësimin e filtrit kryesor dhe të imët të vajit të motorit;
- Të bëjë zëvendësimin e valvulës së sigurimit në magjistralin kryesor;

Në sistemin e ftohjes:

- Të kryejë punime të zakonshme në sistemin e ftohjes së motorit;
- Të bëjë shkarkim dhe mbushje të radiatorit të ujit me lëng ftohës;
- Të bëjë kontrollin e hermetizimit të sistemit ftohës me aparat kontrolli;
- Të bëjë nxjerrjen e ajrit nga sistemi i ftohjes;
- Të zëvendësojë pompën e ujit të motorit;
- Të zëvendësojë ventilatorin e ujit të motorit;
- Të zëvendësojë demferin e ventilatorit të ujit të motorit;
- Të zëvendësojë rezervuarin e ujit dhe të valvulës së ajrit të rezervuarit;
- Të zëvendësojë termostatin e ujit;
- Të zëvendësojë radiatorin e ujit;
- Të zëvendësojë tubat e ujit;
- Të zëvendësojë intercoolerin e ujit;

Në sistemin e ushqimit “diesel”:

- Të kryejë punime të zakonshme në sistemet e ushqimit të motorëve “Diesel”;
- Të bëjë kontrollin e funksionimit të DDE dhe DME
- Të bëjë kontrollin e presionit të rikthimit të lëndës djegëse;
- Të bëjë kontrollin e presionit të ushqimit të lëndës djegëse;
- Të bëjë kontrollin e pompës së presionit të lartë dhe rregullatorit të presionit;
- Të bëjë kontrollin e injektorëve të lëndës djegëse;
- Të bëjë kontrollin e humbjeve në serbator e sistemin e shfryrjes;
- Të bëjë zëvendësimin e radiatorit të lëndës djegëse;
- Të bëjë zëvendësimin e filtrave të lëndës djegëse;
- Të bëjë zëvendësimin e pompës së presionit të lartë të lëndës djegëse;
- Të bëjë zëvendësimin e magjistralit kryesor të lëndës djegëse (RELL-it);
- Të bëjë zëvendësimin e tubacioneve të dërgimit midis injektorit dhe RELL-it;
- Të bëjë zëvendësimin e tubacioneve të dërgimit midis pompës së presionit të lartë dhe RELL-it;
- Të bëjë zëvendësimin e injektorëve;
- Të bëjë zëvendësimin e tubacioneve të dërgimit të lëndës djegëse;
- Të bëjë zëvendësimin e tubacioneve të rikthimit të lëndës djegëse;
- Të bëjë zëvendësimin e centralinos DDE ose DME;
- Të bëjë programimin e centralinos DDE ose DME;
- Të bëjë zëvendësimin e Flometrit të ushqimit të lëndës djegëse;
- Të bëjë pastrimin e serbatorit të lëndës djegëse;
- Të bëjë zëvendësimin e serbatorit të lëndës djegëse;
- Të bëjë zëvendësimin e tubacioneve të furnizimit të lëndës djegëse;
- Të bëjë zëvendësimin e tubacioneve në serbatorin e lëndës djegëse;
- Të bëjë zëvendësimin e treguesit të nivelit të lëndës djegëse;
- Të bëjë zëvendësimin e pompës së presionit të lartë;
- Të bëjë vënien në fazë të pompës së presionit të lartë;
- Të bëjë zëvendësimin e pompës në serbator;
- Të bëjë zëvendësimin e filtrit të ajrit;

- Të bëjë zëvendësimin e kolektorit të thithjes;
- Të bëjë zëvendësimin e tubave të thithjes së ajrit;
- Të bëjë zëvendësimin e kolektorit të shkarkimit;
- Të bëjë zëvendësimin e pompës së depresionit;
- Të bëjë zëvendësimin e tubit të riciklimit të gazeve të kolektorit të shkarkimit;
- Të bëjë zëvendësimin e valvolës së riciklimit të gazeve të kolektorit të shkarkimit;
- Të bëjë zëvendësimin e elektro-valvolës së turbokompresorit;
- Të bëjë zëvendësimin e turbokompresorit të gazeve të shkarkimit;
- Të bëjë zëvendësimin e katalizatorit dhe marmitës;

Në sistemin elektrik të motorit:

- Të kryejë matjet elektrike dhe kontrollin e baterisë;
- Të kryejë matjet elektrike dhe kontrollin e alternatorit;
- Të kryejë matjet elektrike dhe kontrollin e rregullatorit;
- Të kryejë matjet elektrike dhe kontrollin e motorinos;
- Të kryejë kontrollin e kandeletave (në motorët “Diesel”)
- Të bëjë plotësimin e baterisë me sasinë e duhur të elektrolitit;
- Të zëvendësojë baterinë;
- Të bëjë zëvendësimin e rripit dhe të pulexhos së alternatorit dhe regjistrimin e tyre;
- Të bëjë zëvendësimin e alternatorit;
- Të bëjë zëvendësimin e rregullatorit;
- Të bëjë zëvendësimin e motorinos;
- Të bëjë zëvendësimin e kandeleve;

Procese përfundimtare në punimet motorike

- Të bëjë kontrollin përfundimtar të punimeve motorike të kryera;
- Të bëjë kontrollin përfundimtar të motorit dhe mjetit;
- Të japë garanci për punimet e kryera në motor;
- Të përpilojë dokumentacionin teknik për punimet e kryera në motor;
- Të përpilojë listën e materialeve të përdorura;
- Të përpilojë preventivin për punimet e kryera në motor;
- Të përcaktojë kohën e punës për punimet e kryera në motor;
- Të përcaktojë vlerën (çmimin) e punimeve motorike të kryera;
- Të përpilojë faturën për klientin;

Punime xhenerike

- Të çmontojë nga mjete grupet xhenerike;
- Të zbërthejë grupet xhenerike;
- Të pastrojë pjesët e grupeve xhenerike;
- Të seleksionojë pjesët xhenerike;
- Të kryejë matje dhe kontrole të nevojshme për shërbime xhenerike (matje e presionit të ajrit në goma, matje e këndit të rrotave, matja e distancës së rrotave të para, kontrole të konsumimit të frenave dhe diskut të friksionit, etj;) me pajisjet përkatëse;

- Të kryejë punime axhusterie në pjesët xhenerike;
- Të kryejë punime grasatuese në pjesët xhenerike;
- Të montojë pjesët e grupeve xhenerike;
- Të montojë në automjet grupet xhenerike;
- Të kryejë punime të riparimeve të çastit në pjesët xhenerike;
- Të kryejë regjistrimet e duhura në pjesët xhenerike;
- Të bëjë kontrollin përfundimtar të funksionimit të grupeve xhenerike;
- Të përpilojë listën e materialeve të nevojshme për punimet xhenerike;
- Të përcaktojë kohën e nevojshme të punës;
- Të përcaktojë vlerën paraprake të punimeve xhenerike që do të kryhen;

Punime xhenerike të veçanta

Te friksioni:

- Të bëjë kontrollin e funksionimit të friksionit;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të spexhidiskut të friksionit;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të diskut të friksionit;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të kushinetës së friksionit;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të pompave hidraulike të komandimit të friksionit;
- Të bëjë regjistrimin e friksionit;

Te kutia e ndërrimit të shpejtësisë (kambio):

- Të bëjë kontrollin e funksionimit të kambios mekanike /automatike;
- Të zëvendësojë pajisjet elektromekanike në kambion automatike;
- Të bëjë çmontim/montim të kambios mekanike/automatike;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të fiksatorëve/bllokuesve të kambios mekanike;
- Të bëjë zëvendësim të filtrit të vajit të kambios automatike;
- Të eliminojë rrjedhjen e vajit nëambio;
- Të bëjë zëvendësim të pompës centrifugale të kambios automatike;
- Të bëjë zëvendësim të suporteve mbajtës të kambios mekanike/automatike;

Te kutia suplementare e ndërrimit të shpejtësisë (ridoto):

- Të bëjë kontrollin e funksionimit të ridotos;
- Të bëjë zëvendësimin e elektromagnetit të ridotos;
- Të bëjë çmontim/montim të ridotos;
- Të bëjë eliminimin e rrjedhjes së vajit në ridoto;

Te transmisioni kardanik:

- Të bëjë çmontim/montim komplet të boshtit kardanik;
- Të bëjë ekuilibrimin e boshtit kardanik;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të xhuntos së transmisionit kardanik;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të kushinetës centrale të boshtit kardanik;

Te transmisioni kryesor/diferenciali :

- Të bëjë kontrollin e funksionimit të transmisionit kryesor/diferencialit;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të transmisionit kryesor/diferencialit;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të diferencialit para/mbrapa;
- Të bëjë regjistrimin e transmisionit kryesor;
- Të bëjë zëvendësimin e elementëve të diferencialit;
- Të bëjë zëvendësimin e suporteve të gomës për fiksimin e diferencialit të pasmë;
- Të bëjë eliminimin e rrjedhjes së vajit në transmision kryesor/diferencial;

Te gjysmëboshtet (semiakset):

- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të semiakseve para/mbrapa;
- Të bëjë zëvendësimin e gominave të semiakseve para/mbrapa;
- Të bëjë çmontim/montim të kushinetës oshilante;

Te varëset:

- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të stabilizatorit të parë/pasmë;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të balestrave të para/pasme;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të kondrabalestrave të para/pasme;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të amortizatorëve të para/pasme;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim i suporteve mbështetës të amortizatorëve të para/pasme;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të krahëve të stabilizatorit të parë/pasmë;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim i suporteve të gominave të stabilizatorit të parë;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të gominave të stabilizatorit të pasmë;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të krahëve oshilues të stabilizatorit të pasmë;

Te rrotat:

- Të bëjë zëvendësimin e rrotave;
- Të bëjë ndërrimin e vendeve të rrotave;
- Të bëjë balancimin e rrotave;
- Të bëjë konvergencën e rrotave;
- Të bëjë kontrollin dhe rregullimin e presionit të ajrit të gomave;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të mocove të rrotave para/mbrapa;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të kushinetave të rrotave para/mbrapa;

Te ura e parë:

- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të urës së parë;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të krahëve transversal të urës së parë;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të krahëve të sinoblloqeve të urës së parë;
- Të bëjë zëvendësimin e gominave të sinoblloqeve të para;

Te ura e pasme:

- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të urës së pasme;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të krahëve oshilues të urës së pasme;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të krahëve udhëzues të urës së pasme;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të krahëve transversal të sipërm të urës së pasme;
- Të bëjë zëvendësimin e gominave të sinobloqeve të pasme;

Te sistemi i drejtimit:

- Të bëjë kontrollin e funksionimit të sistemit me përforcues hidraulik, pneumatik dhe elektrik;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të pompës hidraulike;
- Të bëjë çmontim/montim e përforcuesit hidraulik, pneumatik dhe elektrik;
- Të bëjë kontrollin e funksionimit të grupit të timonit;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të krahëve të paralelit;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të volantit të timonit;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të boshtit të timonit;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të tubave të sistemit hidraulik;
- Të bëjë kontrollin e lëvizjes bosh të volantit të grupit të timonit;

Te sistemi i frenimit:

- Të bëjë provën e sistemit të frenimit;
- Të bëjë kontrollin e konsumimit të ferrodove të frenave;
- Të bëjë kontroll të sistemit të frenave të dorës;
- Të bëjë zëvendësim të alkoolit të sistemit të frenimit;
- Të bëjë regjistrim të frenave të dorës;
- Të bëjë zëvendësim të ferrodove të rrotave të para;
- Të bëjë zëvendësim të disqeve të frenave të rrotave të para;
- Të bëjë zëvendësim të pincetave të ferrodove të rrotave të para;
- Të bëjë zëvendësim të ferrodove të rrotave të pasme;
- Të bëjë zëvendësim të disqeve të frenave të rrotave të pasme;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të pompës së sistemit hidraulik;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të cilindrit të frenave;
- Të bëjë çmontim/montim ose zëvendësim të enës zgjeruese;
- Të bëjë zëvendësim të tubove fleksibël të sistemit të frenimit;
- Të bëjë zëvendësim të levës së frenave të dorës;
- Të bëjë zëvendësim të sensorëve të ferrodove;
- Të bëjë zëvendësim të servofrenit;

Procese përfundimtare në punimet xhenerike

- Të bëjë kontrollin përfundimtar të punimeve xhenerike të kryera;
- Të bëjë kontrollin përfundimtar të mjetit;
- Të japë garanci për punimet e kryera;
- Të përpilojë dokumentacionin teknik për punimet e kryera;
- Të përpilojë listën e materialeve të përdorura;

- Të përpilojë preventivin për punimet e kryera;
- Të përcaktojë kohën e punës për punimet e kryera;
- Të përcaktojë vlerën (çmimin) e punimeve xhenerike të kryera;
- Të përpilojë faturën për klientin;

Planifikim, organizim dhe përgatitje të shërbimeve të karrocerisë

- Të organizojë vendin e punës për shërbimet e karrocerisë në mjetet e transportit;
- Të përzgjedhë, përdorë dhe mirëmbajë makinat, pajisjet, veglat dhe materialet e punës;
- Të zbatojë standardet e profesionit për shërbimet e karrocerisë;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik për shërbimet e karrocerisë;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar të nevojshëm për pranimin dhe kryerjen e shërbimeve të karrocerisë në mjetet e transportit;
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura sipas proceseve të punës për shërbimet e karrocerisë në mjetet e transportit;

Punime për shërbimet e karrocerisë

- Të çmontojë pjesët e karrocerisë nga mjete të transportit;
- Të zbërthejë pjesët e karrocerisë në elementet përbërëse;
- Të pastrojë pjesët e karrocerisë;
- Të seleksionojë pjesët e karrocerisë;
- Të kryejë matje dhe kontrole të nevojshme për shërbimet e karrocerisë me pajisjet përkatëse;
- Të kryejë punime axhusterie në pjesët e karrocerisë;
- Të kryejë punime grasatuese në pjesët e karrocerisë;
- Të kryejë punime saldimit dhe ngjitjeje në pjesët e karrocerisë;
- Të montojë pjesët e karrocerisë;
- Të kryejë punime të riparimeve të çastit në pjesët e karrocerisë;
- Të bëjë kontrollin përfundimtar të punimeve të kryera në karroceri;
- Të përpilojë listën e materialeve të nevojshme për punimet e karrocerisë;
- Të përcaktojë kohën e nevojshme të punës;
- Të përcaktojë vlerën paraprake të shërbimeve të karrocerisë që do të kryhen;

Punimeve të veçanta në karroceri

Për diagnostikimin e parregullsive:

- Të bëjë kontrollin pamor të parregullsive në pjesët e karrocerisë;
- Të bëjë matjet dhe kontrollet me instrumente për përcaktimin e parregullsive (shformimeve) dhe parametrave gjeometrikë të pjesëve të karrocerisë;

Për zëvendësimin e pjesëve të karrocerisë:

- Të bëjë çmontimin dhe montimin e xhamave të mjetit të transportit;
- Të bëjë çmontimin dhe montimin e dyerve të mjetit të transportit;
- Të bëjë çmontimin dhe montimin e kolonave të dyerve të mjetit të transportit;

- Të bëjë çmontimin dhe montimin e mbulesës së motorit të mjetit të transportit;
- Të bëjë çmontimin dhe montimin e bravave dhe dorezave dyerve të mjetit të transportit;
- Të bëjë çmontimin dhe montimin e mekanizmave të komandimit të xhamave të mjetit të transportit;
- Të bëjë çmontimin dhe montimin e kroskotit të mjetit të transportit;
- Të bëjë çmontimin dhe montimin e pasqyrave dhe fshirëseve të xhamave të mjetit të transportit;
- Të bëjë çmontimin dhe montimin e ndenjësive të mjetit të transportit
- Të bëjë zëvendësimin e tapicerisë së mjetit të transportit;
- Të bëjë çmontimin dhe montimin e parafangove, parakolpeve dhe pjesëve të tjera plastike ose metalike të mjetit të transportit;

Për drejtimin e pjesëve të shformuara të karrocërisë:

- Të bëjë drejtimin e strukturave metalike të deformuara të karrocërisë;
- Të bëjë drejtimin e pjesëve në formë flete metalike të deformuara të karrocërisë (dyert, mbulesat, parafangot, parakolpot etj.);

Për ngjitjen dhe saldimin:

- Të bëjë ngjitje me pasta të pjesëve të dëmtuara plastike dhe metalike të karrocërisë;
- Të bëjë riparime me saldim me gaz të pjesëve metalike të karrocërisë;
- Të bëjë riparime me saldim me hark të pjesëve metalike të karrocërisë;

Për riparimin me lyerje të sipërfaqeve të karrocërisë:

- Të bëjë çmontimin e pjesës së karrocërisë që do të lyhet (nëse është e nevojshme)
- Të bëjë pastrimin dhe smerilimin e sipërfaqes së karrocërisë që do të lyhet;
- Të bëjë stukimin e sipërfaqes së karrocërisë që do të lyhet;
- Të bëjë smerilimin e sipërfaqes së stukuar të karrocërisë që do të lyhet;
- Të bëjë përzgjedhjen dhe përgatitjen e bojës me ngjyrën e duhur;
- Të bëjë mbulimin mbrojtës të sipërfaqeve të karrocërisë që nuk do të lyhen;
- Të bëjë lyerjen me bojë (me disa shtresa) të sipërfaqes së karrocërisë që do të riparohet;
- Të bëjë llakimin dhe pjekjen e sipërfaqes së karrocërisë së lyer;
- Të heqë mbulimin mbrojtës të sipërfaqeve të karrocërisë që nuk lyhen;
- Të bëjë montimin e pjesës së karrocërisë së lyer (nëse është çmontuar);
- Të bëjë kontrollin përfundimtar të pjesës së lyer të karrocërisë;

Procese përfundimtare në shërbimet e karrocërisë

- Të bëjë kontrollin përfundimtar të shërbimeve të karrocërisë të kryera;
- Të bëjë kontrollin përfundimtar të mjetit;
- Të japë garanci për punimet e kryera;
- Të përpilojë dokumentacionin teknik për shërbimet e kryera;
- Të përpilojë listën e materialeve të përdorura;
- Të përpilojë preventivin për shërbimet e kryera;

- Të përcaktojë kohën e punës për shërbimet e kryera;
- Të përcaktojë vlerën (çmimin) e shërbimeve të karrocerisë, të kryera;
- Të përpilojë faturën për klientin;

Planifikimi, organizimi dhe përgatitje për shërbime të agregateve në mjete të rënda të transportit

- Të organizojë vendin e punës për shërbimet e agregateve në mjetet e rënda të transportit;
- Të përzgjedhë, përdorë dhe mirëmbajë makinat, pajisjet, veglat dhe materialet e punës;
- Të skicojë skemën kinematike të funksionimit të agregatit;
- Të zbatojë standardet e profesionit për shërbimet e agregateve;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik për shërbimet e agregateve;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar të nevojshëm për pranimin dhe kryerjen e shërbimeve të agregateve në mjetet e rënda të transportit;
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura sipas proceseve të punës për shërbimet e agregateve në mjetet e rënda të transportit;

Punime për shërbimet e agregateve

- Të çmontojë pjesët e agregateve nga mjetet e rënda të transportit;
- Të zbërthejë pjesët e agregateve në elementet përbërëse;
- Të pastrojë pjesët e agregateve;
- Të seleksionojë pjesët e agregateve;
- Të kryejë matje dhe kontrole të nevojshme për shërbimet e agregateve me pajisjet përkatëse;
- Të kryejë punime axhusterie në pjesët e agregateve;
- Të kryejë punime grasatuese në pjesët e agregateve;
- Të kryejë punime saldimit dhe ngjitjeje në pjesët e agregateve;
- Të montojë pjesët e agregateve;
- Të kryejë punime të riparimeve të çastit në pjesët e agregateve;
- Të bëjë kontrollin përfundimtar të punimeve të kryera në agregatet;
- Të përpilojë listën e materialeve të nevojshme për punimet në agregatet;
- Të përcaktojë kohën e nevojshme të punës;
- Të përcaktojë vlerën paraprake të shërbimeve të agregateve që do të kryhen;

Punimeve të veçanta në agregatet

Për diagnostikimin e parregullsive:

- Të bëjë kontrollin pamor të parregullsive në pjesët e agregateve;
- Të bëjë matjet dhe kontrollet me instrumente për përcaktimin e parregullsive (shformimeve) dhe parametrave gjeometrikë të pjesëve të agregateve;

Për zëvendësimin e pjesëve të agregateve:

- Të bëjë çmontimin dhe montimin e pompës hidraulike të mjeteve të rënda të

- transportit;
- Të bëjë çmontimin dhe montimin e sistemit hidraulik të komandimit të agregatit;
 - Të bëjë çmontimin dhe montimin e kolonës së agregatit përkatës;
 - Të bëjë çmontimin dhe montimin e krahëve punues të agregatit përkatës;
 - Të bëjë çmontimin dhe montimin e zinxhirëve në mjetet e rënda të transportit;
 - Të bëjë çmontimin dhe montimin e hidromotorit në mjetet e rënda me zinxhir;
 - Të bëjë çmontimin dhe montimin e cilindrave hidraulik;
 - Të bëjë çmontimin dhe montimin e (kovës, thikës, etj.) në mjetet e rënda të transportit;
 - Të bëjë ndërrimin e vajit hidraulik;

Për drejtimin e pjesëve të shformuara të agregateve:

- Të bëjë drejtimin e strukturave metalike të deformuara të agregateve;

Për saldimin:

- Të bëjë riparime me saldim me hark ose gaz të strukturës metalike të agregateve të mjeteve të rënda të transportit ;
- Të bëjë riparime me saldim me hark ose gaz të (kovës, thikës etj.) në mjetet e rënda të transportit;

Procese përfundimtare në shërbimet e agregateve

- Të bëjë kontrollin përfundimtar të shërbimeve të kryera në agregatet;
- Të japë garanci për punimet e kryera;
- Të përpilojë dokumentacionin teknik për shërbimet e kryera;
- Të përpilojë listën e materialeve të përdorura;
- Të përpilojë preventivin për shërbimet e kryera;
- Të përcaktojë kohën e punës për shërbimet e kryera;
- Të përcaktojë vlerën (çmimin) e shërbimeve të kryera në agregatet;
- Të përpilojë faturën për klientin;

Sigurimi teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

- Të sigurojë veshjen e përshtatshme për punë;
- Të mbajë pastër vendin e punës;
- Të hedhë mbetjet dhe papastërtitë në vendet e përcaktuara;
- Të sigurojë hapësira të lira për raste rreziku;
- Të sigurojë gatishmërinë e mjeteve zjarrfikëse;
- Të përdorë mjetet zjarrfikëse;
- Të sigurojë vendosjen e mjetit mbi urën ngritëse;
- Të sigurojë vendosjen e motorit të çmontuar në bango;
- Të kontrollojë gjendjen teknike të veglave dhe pajisjeve të punës;
- Të sigurojë ndriçimin e duhur të mjedisit të punës;
- Të sigurojë ajrimin e duhur të mjedisit të punës;
- Të sigurojë mjetet e ndihmës së shpejtë;
- Të japë ndihmën e shpejtë;

- Të kontrollojë tokëzimin e pajisjeve elektrike;
- Të marrë masa që të mos punojë vetëm;

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin “Shërbimi në mjetet e rënda të transportit”, niveli III në KSHK, nxënësi do të përvetësojë kompetencat e përgjithshme të mëposhtme:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të realizojë detyrat bazuar në objektiva të qarta dhe realiste;
- Të komunikojë me të tjerët duke synuar një kuptim të përbashkët lidhur me veprimtaritë e synuara;
- Të demonstrojë aftësi për të përzgjedhur midis alternativave të ndryshme;
- Të manaxhojë kohën në mënyrë eficiente.